



## KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

### VENDIM

Nr. 66 datë 5 . 10 2011

### Për dhënien e ndihmës familjeve të dëmtuara nga zjarri.

Këshilli i Bashkisë Korçë në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Sek. i Shërbimeve Komunitare dhe Emergjencave Civile, Drejtoria e Financës dhe Drejtoria Juridike, “ Për dhënien e ndihmës financiare për familjen e dëmtuar”, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.206 datë 26.03.1998, i ndryshuar, “ Për kriteret për pjesëmarrjen e shtetit në përballimin e demeve në raste fatkeqësish” Ligjin nr.8652 datë 31.07.2000 “ Për organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore” ” neni 32, gërma dh, në ligjin nr.9936dt. 26.062008. “ Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë ” nr 10355 dt. 02.12.2010 “ Për buxhetin e vitit 2011, Udhëzimin nr 4 MF dt. 02.12.2010 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2011” si dhe në VKB nr 44 dt. 28.7.2011 Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2011”

### VENDOSI

1. Të ndihmohet familja e cila u dëmtuan nga zjarri i rënë në banesën e qytetarit Nesti Qeramixhi e ndodhur në lagjen nr 11, në Rrugën “ Gjon Ndreci Pendavinji” nr 15 ” Përbërja e familjes ditën e aksidentit është e vetëtuara nga Zyra e Gjëndjes Civile. Masa e ndihmës për dëmin në pajisje dhe orendi për këtë familje do të jetë si me poshtë:

Familja e qytetarit Nesti Qeramixhi e përbërë nga 3 persona 3x 20000= 60 000 lek

2.Të ndihmohet familja e cila u dëmtuan nga zjarri i rënë në banesën e qytetarit Seit Shaholli e ndodhur në lagjen nr 15, në Rrugën “ Partizani ” pallati nr 10, kati i tretë hyrja C .Përbërja e familjes ditën e aksidentit është e vetëtuara nga Zyra e Gjëndjes Civile. Masa e ndihmës për dëmin në pajisje dhe orendi për këtë familje bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.206 datë 26.03.1998 do të jetë

100 000 lek

3. Dokumenti i plotë, për ndihmën e familjen e qytetarit Nesti Qeramixhi për dëmtimet e shkaktuara në anën ndërtimore, me vlerë **531 744 lek** dhe për familjen e qytetarit Seit Shaholli për dëmet në anën ndërtimore me vlerë **150.924 lek** ti dërgohet Keshillit të Qarkut për t’ia përcjellë për shqyrtim Ministrisë së Brëndëshme. (Dep. të Planifikimin e Përballimit të Emergjencave Civile.

4. Ky fond do të përballohet nga fondi i emergjencave civile të miratuar në buxhetin e Bashkisë për vitin 2011 me strukturë buxhetore:

00 04980            05 Art. 6061041            Vlerë 160 000 lek

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës Sek. Shërbimeve Komunitare dhe Emergj. Civile dhe Drejtoria Juridike.

6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes.

**KRYETARI**

**Ilirjan PENDAVINJI**



Dixhitalizuar nga Qendra ÇIP  
www.infocip.org